



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2695 Prot.
18

Patos më 02.09.2026.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 31.08.2026

I mbajtur sot më datë 31.08.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë:

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltare:

1. Liljana Mesutaj
2. Lori Musaj
3. Artan Velçani
4. Armand Ahmetaj
5. Ertilla Myrtaj
6. Elton Seraj
7. Smerald Hazizaj
8. Elmira Rama
9. Renaldo Shpata
10. Vjollca Kasaj
11. Novrus Toska
12. Eduart Faslliaj
13. Gani Ahmetaj
14. Zejni Musaj

Takimi hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj.

Të nderuar qytetarë, anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Pjesmarrja në mbledhje është 14 këshilltarë.

Mbledhja bazohet dhe zhvillohet në bazë të nenit 53 pika 4 neni 56 pika 2 gërma a të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore si dhe Rregullores për organizimin dhe funksionimin e këshillit bashkiak.

Lexojmë rendin e ditës

- 1- Miratimi i rendit të ditës.
- 2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 29.07.2026 dhe 06.08.2026.
- 3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 29.07.2026 dhe 06.08.2026.
- 4-Projekt-vendim "Për dhënien e mandatit të anëtarit të këshillit bashkiak znj. Elvida Kalem.
- 5- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin korrik 2026".

6- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin korrik 2026".

7- Projekt-vendim "Për përcaktimin e kriterëve të pranimit të personave me aftësi të kufizuar 3-21 vjeç në qendrën Multifunktionale në Bashkinë Patos.

8- Projekt-vendim "Për shfuqizimin e VKB-së nr. 44 datë 29.07.2026 "Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për vitin 2026 për mbrojtjen civile, për blerjen e një skrepi me zinxhir".

9- Projekt-vendim "Për autorizimin e juristes znj. Nurkë Hazizaj për të përfaqësuar Këshillin e Bashkisë Patos si pale e paditur në procesin gjyqësor me paditës z. Gëzim Beqaj.

Çështjet kanë kaluar për shyrtime në Komisionin e Ekonomisë, Financës dhe Ndihmave Ekonomike i cili ka shqyrtuar pikat 5,6, Komisioni i Arsimit Shëndetësisë Kulturës Rinisë dhe Sporteve ka shqyrtuar pikën 7 dhe komisioni i Ligjeve Marrëdhëniet me Komunitetin dhe Jashtë, ka shqyrtuar pikën 8,9

Para se të kalojmë në votimin e rendit të ditës dua tju pyes nëse keni ndonjë kërkesë për të shtuar apo hequr nga rendi i ditës.

Kush është dakord me rendin e ditës?

Miratohet me 14 vota pro, asnjë abstenim, asnjë kundër.

SEKRETARE


Refaela Xeba



Cori Musqaj
Enkela Myrtaj
Gëzim Beqaj
Smeralda Hotiraj
[Signature]

KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2695 Prot.
19

Patos më 02.09.2026

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.08.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 29.07.2026 dhe 06.08.2026.

Armand Ahmetaj – Procesverbalin si material e keni pasur. Keni ndonjë verejtje, ndonjë kërkesë për korrigjimin e procesverbalit? Atëherë kalojmë për miratimin e procesverbalit datë 29.07.2026 dhe 06.08.2026.

Miratohet me 14 vota pro, asnjë abstenim, asnjë kundër.

SEKRETARE

Refaela Xeba

Lori Musaj Haf
Erkida Myrtezi
Smeropol Hoxha

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2695 Prot.
10

Patos më, 02 09.2026

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.08.2026 në orën 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 29.07.2026 dhe 06.08.2026.

Armand Ahmetaj– Fjala për Refaelën

Refaela Xeba -Përshëndetje të gjithëve!

Në mbledhjen e datës 29.07.2026 u morën gjithsej 8 vendime nga nr. 39 deri ne 46. Nga këto vendime, vendimi me nr. 41, 42, 44 dhe 45 i janë përcjell Prefekturës për verifikim dhe na ka ardhur përgjigja se vendimi me numer 41, 42 dhe 45 janë në përputhje me ligjin ndersa vendimi nr. 44 rezulton ne kundërshtim me piken 13 te nenit 3 te ligjit 68/2017 “Për financat e veteqeverisjes vendore.

Në mbledhjen e datës 06.08.2026 u morën gjithsej 3 vendime nga nr. 47 deri ne 49.

Vendimet janë zbardhur në afat dhe i janë përcjell drejtorive përkatëse për ekzekutim.

Faleminderit!

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Cori Musaj
Erkida Myrtaj
Smerodol Potica
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2018/ Prot.
10

Patos më 02.09.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.08.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për dhënien e mandatit të anëtarit të këshillit bashkiak znj. Elsida Kalemi".

Armand Ahmetaj- Paraprakisht komisioni e mandateve do të lexoj raportin i cili është hartuar për procedurën e ndjekur që nga koha e krijimit të vendit vakant në këshill.

Ertla Myrtaj- Kryetare komisioni të mandateve

Komisioni i mandateve u mblodh më datë 26.08.2026 ora 13:00 për shqyrtimin e dokumentacionit të përcjellë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për znj. Elsida Kalemi zgjedhur si këshilltar bashkiak i Partisë Socialiste në Bashkinë Patos.

Komisioni konstaton se:

Dokumentacioni është i plotë dhe përputhet me kërkesat ligjore;

Nuk ka pengesa ligjore për marrjen e mandatit

Subjekti ka respektuar afatet e dorëzimit të vetëdeklarimit;

Komision me shumicë votash vendosi:

T'i propozojë Këshillit Bashkiak miratimin e mandatit të këshilltarit bashkiak për znj. Elsida Kalemi.

Armand Ahmetaj- Jeni të hapur për diskutime?

Armand Ahmetaj –Nëse s'kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim raportin e komisionit Kush është dakord me raportin e komisionit?

Miratohet me 14 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

Armand Ahmetaj- ftoj znj. Elsida Kalemi të bëj betimin "Betohem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të këshillit bashkiak dhe do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve, betohem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të bashkisë patos dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre. Elsida Kalemi- betohet.

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Loti Musaj
Ertla Myrtaj
Smegjela Hotica



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2626 Prot.

13

Patos më 02 09.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.08.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin qershor 2026”.

Mitjon Nikolla – projektvendim nr. 47 datë 12.08.2026 “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin korrik 2026”.

Drejtoria e Finances, Drejtoria e Mbrojtjes Sociale, Arsimit, Kulturës dhe Sportit, Sektori i Shërbimit Social propozon të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e buxhetit vendor për muajin Korrik 2026 gjithsej 17 familje me një fond prej 77,888 (shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë..

Armand Ahmetaj- Jeni të hapur për diskutime?

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e pestë Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin qershor 2026”.

Kush është dakord?

Miratohet me 15 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE

Refaela Xeba

Loni Musaj

Smerqel Hoerz

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 26241 Prot.
3

Patos më 02 09.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.08.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin qershor 2026”.

Mitjon Nikolla – projektvendim nr. 48 datë 12.08.2026 “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin qershor 2026”.

Drejtoria e Finances, Drejtoria e Mbrojtjes Sociale, Arsimit, Kulturës dhe Sportit, Sektori i Shërbimit Social propozon të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6% për muajin Korrik 2026 gjithsej 18 familje me një fond prej 67,792 (gjashtëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë.

Lori Musaj- Komisioni ekonomisë u mbledh ditën e premte dhe është diskutuar mbi këtë pikë e cili është argumentuar në përputhje me bazën ligjore dhe e kemi votuar pa asnjë ndryshim me tre vota pro.

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e gjashtë Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin qershor 2026”.

Armand Ahmetaj – Kush është dakord?

Miratohet me 15 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Lori Musaj

Erkida Myrtaj
Smerdet Ahmetaj

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2692 Prot.
13

Patos më 02 09.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.08.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për përcaktimin e kriterëve të pranimi të personave me aftësi të kufizuar 3-21 vjeç në qendrën Multifunksionale në Bashkinë Patos.

Mitjon Nikolla – projektvendim nr. 49 datë 19.08.2026 “Projekt-vendim “Për përcaktimin e kriterëve të pranimi të personave me aftësi të kufizuar 3-26 vjeç në qendrën Multifunksionale në Bashkinë Patos.

Referuar kërkesave të familjarëve të personave me aftësi të kufizuar të kryera gjatë vitit të kaluar dhe rekomandimeve të lëna nga Shërbimi Social Shtetëror Kombëtar, Kryetari i Bashkisë ka ngritur grup pune për vlerësimin e kriterëve të pranimi në Qendrën Multifunksionale.

Kriteret janë si më poshtë;

- I. Miratimin e kriterëve të pranimi të personave me aftësi të kufizuara, të cilat janë miratuar me vendim të Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të aftësisë së kufizuar, Komisioneve mjeko-ligjore, KMCAP-ve të neurologji-tetraplegji;
 1. T’i përkasin grupmoshës 3 deri në 21 vjeç (përparësi do të ketë mosha më e hershme) me qëllim parandalimin dhe përmirësimin e fëmijëve.
 2. Fëmijë të cilët nuk frekuentojnë çerdhet, kopshtet apo shkollat për shkak të aftësisë së kufizuar.
 3. Fëmijët dhe të rinjtë të cilët nuk frekuentojnë institucione apo qendra të tjera publike ose private të përkujdesjes shoqërore.
 4. Fëmijët dhe të rinjtë që jetojnë në familje me vështirësi sociale, ekonomike ose shëndetësore.
 5. Fëmijë me status familjar jo të favorshëm (prindër të divorcuar, kujdestari nga familjarë, prindër PAK ose me probleme të tjera të rënda shëndetësore që çenojnë prindërimin).
 6. Përparësia për përfitimin e shërbimit në Qendrën Multifunksionale, deri më sot ne kemi vende bosh dhe nuk kemi arritur të përdorim pjesën e përparësisë;
 - a) Fëmijë me aftësi të kufizuar intelektuale, fëmijë me çrregullime të spektrit Autik, fëmijë me çrregullime të të nxënit, fëmijë me sindroma të ndryshme (sindroma Daën).
 - b) Fëmijë me aftësi të kufizuar fizike (paraplegjike, tetra-plegjike, hemiplegjike)
 - c) Fëmijë me dëmtime shqisore (nuk përfshihen fëmijët me dëmtim të plotë të shikimit ose dëgjimit pasi këta fëmijë marrin shërbim në shkolla speciale, nuk janë pjesë e qendrës sonë por zakonisht i jemi referuar pjesës së të folurit, probleme në të folur ku së bashku me ju kemi ngritur dhe shërbimin e logopedisë të cilën e keni miratuar.

Këtu do shtoja dhe pikën 4 gjendja e ekonomike e familjes familjet me vështirësi më të mëdha ekonomike do jenë prioritet.

Vjollca Kasaj- Qendra Multifunkionale për personat me aftësi ndryshe është një institucion i shërbimeve shoqërore që synon rritjen e cilësisë së jetës, integrimin e plotë të kësaj kategorie në shoqëri. Që nga krijimi i saj kjo qender ka funksionuar normalisht dhe ka afruar shërbime shumë individëve duke ofruar shërbimin e saj. Roli kryesor ka qënë në shërbim rehabilitimi në shërbime psiko sociale, këshillim psikologjik, zhvillim të aftësisë dhe edukim informues me aktivitete të ndryshme që ka zhvilluar kjo qëndër dhe aktivitete kulturore. Kriteret që ka vendosur për pranimin e individëve në këtë qendër janë bazuar në kuadrin ligjor që ofron shërbimi dhe mbrojtja sociale kështu që këto kriteret ne si komision që ky projekvendim të miratohet nga ne si këshill.

Novrus Toska- Më duket i mirëmenduar për të gjitha kriteret dhe ftoj kolegët ta miratojmë.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim tjetër?

Armand Ahmetaj – Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e shtatë Projekt-vendim “Për përcaktimin e kriterëve të pranimit të personave me aftësi të kufizuar 3-21 vjeç në qendrën Multifunkionale në Bashkinë Patos.

Kush është dakord?

Miratohet me 15 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE

Refaela Xeba



KRYETAR

Armand Ahmetaj

Lon' Musaj' Mad

Edhira Myrtaj

Smerple Hotitaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2410 Prot.
13

Patos më 02 09.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.08.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për shfuqizimin e VKB-së nr. 44 datë 29.07.2026 “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për vitin 2026 për mbrojtjen civile, për blerjen e një skrepi me zinxhir”.

Arben Shpërdheja – projektvendim nr. 51 datë 24.08.2026 “Për shfuqizimin e VKB-së nr. 44 datë 29.07.2026 “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për vitin 2026 për mbrojtjen civile, për blerjen e një skrepi me zinxhir”.

Në këtë këshill bashkiak u mor vendimi për përdorimin e fondit të kushtëzuar 44 datë 29.07.2026 me shkresën nr. 242/3 prot të ardhur nga Prefektura ku nuk pretendohet se është në kundërshtim me ligjin por për rishikim të këtij vendimi ku ne me shkresën nr. 1326/4 prot datë 26.07.2026 i jemi drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes AKMC për kalimin e këtij fondi në grupin e produktit AD. Deri në këtë moment nuk na ka ardhur përgjigja nga Ministria dhe me të drejtë Prefektura kërkon që në moment që do të vij shkresa nga Ministria atëherë do ta quaj të ligjshëm këtë vendim dhe e ka kthyer për rishikim për saktësim dhe të sekretares që tha në kundërshtim. Pra u kthye për rishqyrtim.

Novrus Toska- Pra ne këtë vendim e kemi marrë para kohe.

Arben Shpërdheja- Ministria e dërgon këtë fond të ndarë në dy grupe. Në grupin e parë që ishin në mos gaboje 4.8 milion lekë ne miratuar fondin për dy përrenj për të vazhduar lotin 3 të përroit në lagjen e Re dhe vazhdimin e lotit në lagjen Naftëtari pjesa e mbetur ne i kërkuam Ministrisë me shkresë zyrtare për ta kaluar këtë fond në investime dhe ishim të bindur që do vinte por nisur nga arsyet, dhe kaluam në mbledhjen e këshillit bashkiak radhën e parë me vendimin 44 për ta miratuar për të vazhduar procedurën, është dhe një fakt tjetër në datën 30 tetor ne do të kemi përfunduar procedurat e gjithë vlerave financiare sepse Ministria thote se në rast se ju nuk harxhoni ato tërhiqen mbrapa ndaj dhe ne nxituam.

Eduart Faslliaj- Për ta qartësuar ka një fond emergjence që e ndajmë në dy kategori, në përqindje të vlerës e ndan apo si e ndan?

Arben Shpërdheja-vinte fondi në total dhe na kërkonte ne që këtë fond si do ta ndanim dhe ne i kthenim përgjigje. Këtë radhë erdhi i ndarë në vlera të barabarta pra u shtua vlera nqs se deri vjet vinin rreth 50 milion -55 milion lekë sivjet erdhën 98 milion lekë dhe i ndarë në dy pjesë një pjesë për investim dhe një për të ndarë familjet që mund të kenë dëmtime natyrore ose nga zjarret.

Eduart Faslliaj-ne e kemi ezauruar pjesën e fondit që kishim për investim dhe na ka ngelur te pjesa e fondit kjo pjesa e lekëve që ne menduam ta kalonim nga fondi për emrgjencat për familjet e dëmtuara në fondin e investimeve po kërkesa Ministrise u bë mbase erdhi nga Prefektura apo ishte bërë dhe ju mendonit se përgjigja do vinte pozitive.

A ka pasur raste të ngjashme nga bashkitë e tjera që kanë bërë kërkesa të kësaj natyre dhe janë aprovuar apo jo? Do miratohet apo thjesht presim?

Arben Shpërdheja- shkresa është bërë në datën 20.07.2026 ministrisë duke kontaktuar dhe me ata dhe m vendimi 44 është marrë në datën 29. Pra me shpresën se do vinte .

Eduart Faslliaj-afati djeties së fondit kur është?

Arben Shpërdheja- ata thonë në mbledhjen e fund vitit por më 30 tetor ata kërkojnë të mbyllet buxheti dhe ne jemi të interesuar që ky fond mos tna digjet. Ndërsa a kemi ne vlera për të ndihmuar familjet në nevojë gjithë bashkia jonë ka punuar me parandalimin dhe deri më sot shyqyr jemi mire.

Eduart Faslliaj- Një pyetje kisha për sekretaren ne në fillim kemi miratuar nje fond për blerjen e ketij mjeti nga një fond në buxhet, dhe ate fond e kemi përdorur për dicka tjetër? Dhe në rast se kur nuk na miratohet nga ministria dhe ne nuk kemi mundësi të opërojmë me këtë kontigjenë lekësh që na ngelen nga emergjencat do ngelemi pa mjet apo do marim fondin që kishin dhe do e blejmë mjetin

Sekretare Pergjithshme- Nuk e kam këtë informacion

Elmira Rama- pse duhet ta shfuqizojmë në momentin kur ne nuk kemi një përgjigje nga Ministria?

Arben Shpërdheja- jemi të detyruar nga ana ligjore.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim tjetër?

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e tetë Projekt-vendim “Për shfuqizimin e VKB-së nr. 44 datë 29.07.2026 “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për vitin 2026 për mbrojtjen civile, për blerjen e një skrepi me zinxhir”.

Kush është dakord?

Miratohet me 13 vota pro pasi dy këshilltaë janë larguar nga salla z. Artan Velçani dhe Zejni Musaj, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba



KRYETAR

Armand Ahmetaj



Loni Musaj
Eshler Myrtaj
Smeralda Hoed




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2693 Prot. 12

Patos më 02 09.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 31.08.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së nëntë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për autorizimin e juristes znj. Nurkë Hazizaj për të përfaqësuar Këshillin e Bashkisë Patos si pale e paditur në procesin gjyqësor me paditës z. Gëzim Beqaj.

Besoj jemi të qartë që autorizojmë juristen e bashkisë që tna përfaqësoj në një proces gjyqësor. Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim tjetër?

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e nëntë Projekt-vendim "Për autorizimin e juristes znj. Nurkë Hazizaj për të përfaqësuar Këshillin e Bashkisë Patos si pale e paditur në procesin gjyqësor me paditës z. Gëzim Beqaj.

Kush është dakord?

Miratohet me 13 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

Eduart Faslliaj- Kisha 2 pyetje, ka një sensibilitet nga komuniteti i Fshatit Gjyνοqarë lidhur me investimin në rrugën po ju drejtohem juve. Në dijeninë time me sa mbaj mend investimi është shtrirë në dy vite në dy buxhete dhe përfundon në fund të këtij viti. Donin të dinin kur do vazhdojnë punimet se ndoshta një pjesë e tyre janë duke na ndjekur live. Doja të dija kur fillojnë muret mbajtëse dhe kur përfundojnë? Ato mure mbajtëse që ne kishim aplikuar te ai fondi emergjencës që na ishte miratuar dhe sa do zgjasin punimet janë parashikuar në fund vitit apo do mbarojnë herët apo do shtrihen në kohë dhe vitin tjetër?

Juela Shpata- Muret mbajtëse janë në proces prokurimi, janë në përfundim të vlerësimit, presim afatet e ankimimit mbyllet kontrata. Pas përfundimit të vlerësimit është 7 ditëshi ankesave nëse shpallet një fitues është 7 ditëshi ankesave dhe më pas lidhet kontrata dhe fillojnë punimet. Persa I përket afatit të interesohem dhe të them

Eduart Faslliaj-që do të thotë deri nga fundi i këtij muaj maksimumi ne fillojmë me procesin e bërjes së mureve mbajtëse

Juela Shpata-nëse nuk kemi ankesa po.

Eduart Faslliaj-kur fillon berja e mureve mbajtëse? Sa kohë na mer? Dhe a do arrijmë ta përfundojmë deri në fund të vitit të tëra punimet berjen e mureve dhe asfaltimet

Boreta Murati- objekti për ndërtimin e mureve mbajtëse momentalisht ndodhet në fazën e prokurimeve por ne nuk e dimë sesi do zhvillohet ky proces se mund të ketë dhe deshtim të procesit të prokurimit që do të thotë mund të ketë anullim të herës së parë dhe mund të rihidhet në herën e dytë. Me përfundimin e këtij procesi dhe afatit të ankimimit do të bëhet lidhja e kontratës me subjektin fitues dhe shpresojmë shumë të ketë një fitues që më pas menjëherë të fillojmë me zbatimin e e punimeve. Me shpres duke marrë parasysh që sdo kemi dështime apo ankimime

mendoj deri në fund të shtatorit do kemi një fitues paraprak dhe me pas fillojmë me punimet e cila nuk zgjat me shumë se dy muaj dhe deri në fund të dhjetorit ne do fillojmë me asfaltimin. Janë dy objekte të ndryshme asfaltimi rrugës është me marrëveshje kuadër ndërsa ndërtimi i mureve mbajtës është projekt i vecantë nga AKMC bashkëfinancim me bashkinë. Brenda muajit dhjetor ne përfundojmë të dy projektet për fshatin Gjynoqarë për rrugën Ymeraj ndërtimi i mureve përgjatë rrugës Ymeraj dhe shtrimi i rrugës me asfalt në këtë segment.

SEKRETARE

Refaela Xeba



KRYETAR

Armand Ahmetaj

Lon' Musaj
Erhida Myrtaj
Smerodol Koceti

